



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste

*D. G. Parlamenti
T: Pasi p. 709 sa me e
Parlamenti
Ece*

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____ 2018

Lënda : Amendamente për “Projektkodin e Sjelles së Deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë”

Drejtuar : Kryetarit të Kuvendit
Z. Gramoz RUÇI

K ë t u

I nderuar zoti Kryetar,

Bazuar në nenin 75 të Rregullores së Kuvendit po paraqesim për shqyrtim dhe miratim në seancë plenare amendamentet në projektkodin e Sjelles së Deputetëve.

Bashkëlidhur do të gjeni relacionin shpjegues dhe formulimet përkatëse, të cilat bazohen në komentet dhe rekomandimet e ekspertizës së ardhur nga OSBE/ODHIR, pas kërkesës së bërë në mbledhjen e Këshillit të Rregullores dhe Mandateve si dhe tekstit të përmirësuar edhe me rekomandimet e ekspertit të Këshillit të Evropës, pas përfundimit të shqyrtimit të Kodit në parim, nen për nen dhe në tërësi.

Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste

Taulant BALLA

RELACION SHPJEGUES PËR AMENDAMENTET

Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste, pasi u njoh me komentet dhe rekomandimet e sjella nga OSBE/ODHIR, pas ekspertizës së specializuar në lidhje me Kodin e Sjelljes së Deputetëve, duke vlerësuar rëndësinë e tyre për përmirësimin në mënyrë të ndjeshme cilësisht të tekstit të projektkodit, i mori ato në konsideratë.

Ky relacion shpjegues referon të gjitha rekomandimet dhe komentet e bëra nga eksperti, të cilat janë riformuluar si amendamente konkrete për nenet respektive të këtij kodi.

Konkretisht u morën në konsideratë rekomandimet si më poshtë:

➤ Lidhur me nenin 1 rekomandimi si vijon :

Merrni në konsideratë formulimin “*për të ndihmuar organizatat e shoqërisë civile dhe publikun e gjerë, duke ofruar një grup të qartë standartesh etike, me anë të të cilave ti bëjnë deputetët të përgjegjshëm, duke kontribuar për më shumë transparencë dhe qartësi në lidhje me parakushtet e detyrës së tyre si deputetë*”;

➤ Lidhur me nenin 3 rekomandimi si vijon :

Hiqen pikat ë,f dhe g të nenit 3.

Merrni në konsideratë të shmangni përsëritjet në pikat 3.ë), 3.f) dhe 3.g), të gjitha trajtojnë parimin e konfliktit të interesit.

➤ Lidhur me nenin 6 rekomandimi si vijon :

Shtohet një nen i ri.

Gjuha jo-parlamentare

Përdorimi në Parlament i gjuhës fyese, provokuese apo kërcënuese është rreptësisht e ndaluar. Sulmet personale, ofendimet dhe gjuha e pahijshme nuk paracaktohen. Në trajtimin e gjuhës jo-parlamentare Kryetari merr parasysh tonin, mënyrën dhe qëllimin e deputetit që flet; personin të cilit i janë drejtuar fjalët; shkallën e provokimit; dhe, më e rëndësishmja, nëse fjalët krijuan rrëmujë në Parlament. Si rrjeshim, gjuha e konsideruar si jo-parlamentare një ditë, jo detyrimisht mund të konsiderohet jo-parlamentare ditën tjetër. Nëse Kryetari do të përcaktojë se është përdorur gjuhë ofenduese ose gjuhë jo e rregullt, deputetit që ka fyer do ti kërkohet të tërheqë fjalën apo frazën jo-parlamentare. Deputeti duhet të ngrihet në vendin e tij ose të saj për të tërhequr fjalën (t) pa mëdyshje.

➤ Lidhur me nenin 6 rekomandimi si vijon :

Shtohet një nen ose pikë e re.

Është e ndaluar që deputetët të votojnë në emër të një kolegu tjetër, i cili nuk është i pranishëm në sallë dhe është e ndaluar që deputetët të kërkojnë kolegëve të votojnë në emër të tyre. Nëse kjo ndodh, do të konsiderohet si shkelje e rëndë e kodit dhe rezultati i votimit do të shpallet i pavlefshëm.

➤ Lidhur me nenin 7 rekomandimi si vijon :

Merrni në konsideratë të shtoni në pikën 1. Mundësinë për gratë deputete që kanë fëmijë të porsalindur që të ndjekin punimet parlamentare bashkë me to, për shembull duke përfshirë formulimin e mëposhtëm ose një formulim të ngjashëm me këtë: Parlamenti do të rishikojë në mënyrë të vazhdueshme kushtet e punës dhe kulturën operationale, për tu siguruar se ka mundësi të barabarta për gratë dhe burrat, si për deputetët, ashtu dhe për stafin;

- Lidhur me nenin 7, rekomandimi si vijon ;

Shtohet një nen i ri :

Merrni në konsideratë të përfshini si më poshtë, ose diçka të ngjashme:

Deputeti duhet të përdorë kohën e punës, burimet parlamentare, stafin e parlamentit, si dhe pronën e parlamentit vetëm për të kryer detyrën që i është ngarkuar;

Deputetët nuk duhet ta venë stafin e parlamentit në pozita të tilla që bien ndesh me, ose vënë në pikëpyetje paanësinë politike të stafit, ose që mund të shkaktojnë kritika se njerëzit që paguhen nga fondet publike po përdoren për qëllime politike partiake.

- Lidhur me nenin 8, rekomandimi si vijon ;

Shtohet pika 3/1

Merrni në konsideratë të shtoni formulimin e mëposhtëm apo diçka të ngjashme: Deputeti nuk ka të drejtë të votojë për një projektligj apo dokument tjetër politik kur ka konflikt interesi; dhe as nuk do të promovojë projektligje apo interesa për shpërblim/pagesë ose për përfitime direkte/indirekte; Nëse duket se gjatë procesit të miratimit të një ligji janë shkelur rregullat për konfliktet e interesit, mund të bllokohet kalimi i ligjit të miratuar për nënshkrimin e Presidentit të Republikës.

- Lidhur me nenin 14, rekomandimi si vijon ;

Shtohet si pikë më vete në këtë nen.

Merrni parasysh formulimin e mëposhtëm ose të ngjashëm: a) Deputetët nuk do të ndihmojnë organizata ose persona të cilët mund të ndikojnë në Parlament, në këmbim të pagesave ose stimujve ose shpërblimeve të tjera; b) Marrëdhëniet e anëtarëve me lobistët gjithmonë do të qeverisen nga parimet e integritetit dhe të sinqeritetit/hapjes; c) Hapja dhe transparenca e kontakteve të deputetëve me palët e treta dhe lobistët do të zbatohet për të gjitha kontaktet, duke përfshirë kontaktet jashtë mbledhjeve të Parlamentit dhe komisioneve të tij.

- Lidhur me nenin 15, rekomandimi si vijon;

Fshihet neni 14/1 dhe në mënyrë të pandashme fshihet dhe neni 15/2

Merrni në konsideratë fshirjen e nenit 15/1;

- Lidhur me kreun III/1 rekomandimi si vijon;

Shtohet nen i ri

Merrni në konsideratë fjalitë e mëposhtme a) Ky kod nuk do të kufizojë të drejtat dhe imunitetin e deputetit siç është përcaktuar me ligj dhe sipas Rregullores së Parlamentit; b) Procedura për heqjen e imunitetit rregullohet nga legjislacioni përkatës kombëtar; c) Duke respektuar legjislacionin ekzistues, një deputet nuk do të përfitojë nga të drejtat e tij të imunitetit për të abuzuar me pushtetin dhe për të shmangur ndjekjen penale për veprime penale, përfshirë korrupsionin dhe shpërdorimin e detyrës.

- Lidhur me nenin 15/3 dhe nenin 15/4 , rekomandimi si vijon :

Merrni në konsideratë fshirjen e nenit 15/3 dhe 15/4 dhe përfshini dispozitat e tyre sipas nenit 14, duke shmangur veçimin e organizatave të shoqërisë civile.

- Lidhur me nenin 16, rekomandimi si vijon:

Neni 16/3 shtohet te neni 9/1

Të gjitha pikat e përmendura në Nenin 16, duket se janë përsëritje të pikave të mëparshme. Në veçanti, pika 3. mund të përmendet në nenit 9.

- Lidhur me nenin 17, rekomandimi si vijon:

Neni 17/1 është hequr dhe është shtuar pas nenit 3/g.

Konsideroni përfshirjen e pikës 1. (dhe 2?) në nenin 3.g) i cili gjithashtu merret me përdorimin e informacionit konfidencial nga deputetët.

- Lidhur me nenin 17, rekomandimi si vijon:

Konsideroni shtimin e formulimit të mëposhtëm ose të ngjashëm: a) Deputeti do të kryejë detyrat e tij parlamentare pa u ndikuar nga mundësitë potenciale të karrierës së ardhshme në sektorin privat, ose pa u ndikuar nga ish kolegët; b) Për një vit nga përfundimi i mandatit të tyre, deputetët nuk do të hyjnë në ndonjë marrëdhënie kontraktuale konsultuese apo kontratë pune tjetër biznesi ose individuale me Parlamentin apo me ndonjë institucion zyrtar mbi të cilin kanë pasur kompetenca të mbikëqyrjes gjatë mandatit të tyre; c) Deputeti nuk do të hyjë në ndonjë këshillim apo marrëveshje tjetër tregtare me Parlamentin apo ndonjë institucion tjetër zyrtar që ai/ajo ka mbikëqyrur gjatë një viti pas largimit nga parlamenti.

- Lidhur me kreun V, rekomandimi si vijon:

Konsideroni të shtoni dispozita specifike që kanë të bëjnë me rritjen e vetëdijes dhe këshillat etike për deputetët, për shembull duke përfshirë: a) Induksionin në fillim të mandatit të parlamentit, i cili përfshin aktivitete këshillimi dhe shkëmbimi të përvojave ku përfshihen deputetët e rinj dhe ato me përvojë; b) Vendojsa e kodit në dispozicion të të gjithë parlamentarëve dhe partive politike të përfaqësuara në parlament; c) Deputetët mund të konsultohen me një organ të caktuar para se të veprojnë për një çështje etike dhe kur ata janë në dyshim për rrjedhën e veprimit; d) Publikimi i Kodit të Sjelljes dhe të Etikës në faqen e internetit të Parlamentit; e) Të mbahet, të paktën një herë në vit, një takim konsultativ me OSHC-të për zbatimin e kodit.

Për sa më sipër, paraqesim amendamentet si vijon:

1. Në nenin 1, shtohet shkronja “d” me përmbajtjen si më poshtë:

“d) të ndihmojë organizatat e shoqërisë civile dhe publikun e gjerë, duke ofruar një grup të qartë standartesh etike, me anë të të cilave ta bëjnë deputetin të përgjegjshëm, për të kontribuar me transparencë dhe qartësi në lidhje me detyrën e tij si deputet” .

2. Në nenin 3, hiqen shkronjat “ë” dhe “f”.

3. Neni 6 të riformulohet si më poshtë:

Neni 6

Gjuha joparlamentare dhe diskriminuese

1. Deputeti nuk duhet të:

- a) përdorë një gjuhë të shprehuri, e cila promovon urrejtjen në bazë të racës, fesë, përkatësisë etnike, origjinës kombëtare, gjinisë, orientimit seksual, identitetit gjinor, prejardhjes sociale, aftësisë së kufizuar, ngjyrës, etnisë, gjendjes ekonomike, arsimore, shoqërore ose shëndetësore, moshës, gjendjes civile, familjare ose martesore, përgjegjësisë prindërore, predispozicionit gjenetik, përkatësisë në një grup të vecantë ose çdo shkak tjetër;
- b) shfaqë forma diskriminimi dhe stereotipizimi në komunikimin e përditshëm, në fjalime politike, në veprimtari parlamentare ose jashtëparlamentare ku merr pjesë.

2. Përdorimi në Kuvend i gjuhës fyese, provokuese apo kërcënuese është rreptësisht e ndaluar. Sulmet personale, ofendimet dhe gjuha e pahijshme nuk paracaktohen. Në trajtimin e gjuhës jo-parlamentare Kryetari merr parasysh tonin, mënyrën dhe qëllimin e deputetit që flet, personin të cilit i janë drejtuar fjalët, shkallën e provokimit, dhe, nëse fjalët krijojnë rrëmujë në punimet e Kuvendit. Kur Kryetari i Kuvendit vlerëson se është përdorur gjuhë ofenduese ose gjuhë jo e rregullt, deputetit që ka fyer i kërkohet që të tërheqë fjalën apo frazën jo-parlamentare. Deputeti ngrihet në vendin e tij ose të saj për të tërhequr fjalën dhe kërkuar ndjesë pa mëdyshje.

3. Në rast të shkeljeve së pikave 1 dhe 2 të këtij neni, përveç sa parashikohet në pikën 2 të këtij neni, ndaj deputetit zbatohen masat disiplinore sipas procedurave të përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit.

4. Pas nenit 6, shtohet neni 6/1 me përmbajtje si më poshtë:

Neni 6/1

Votimi për të tretët

- 1. Gjatë votimit në Kuvend dhe në komisione, deputeti ndalohet që të votojë në emër të një kolegu tjetër, i cili nuk është i pranishëm në sallë.
- 2. Deputeti që nuk është i pranishëm në procesin e votimit, ndalohet që t'i delegojë votën e tij një kolegu.
- 3. Votimi për të tretët konsiderohet shkelje e rëndë e Kodit të Sjelljes dhe e Rregullores së Kuvendit.

4. Një kryetar grupi, ose 7 deputetë mund të kërkojnë shpalljen të pavlefshmëm të votimit sipas procedurave të parashikuara në Rregulloren e Kuvendit.

5. Në nenin 7, pas pikës 3, shtohen pikat 4 dhe 5 me përmbajtjen si më poshtë:

“4. Kuvendi krijon mundësinë për gratë deputete që kanë fëmijë të porsalindur, që të ndjekin punimet parlamentare bashkë me to, duke rishikuar në mënyrë të vazhdueshme kushtet dhe kulturën e punës;

5. Kuvendi siguron mundësi të barabarta për gratë dhe burrat, si për deputetin dhe për stafin mbështetës.”

6. Pas nenit 7, shtohet neni 7/1 me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 7/1

Përdorimi i burimeve parlamentare dhe stafit

1. Deputeti duhet të përdorë kohën e punës, burimet parlamentare, stafin e parlamentit, si dhe pronën e parlamentit vetëm për të kryer detyrën që i është ngarkuar.

2. Deputeti nuk duhet ta vendosë stafin e Kuvendit, që paguhet nga fondet publike, në pozita që të bien ndesh me paanësinë politike të stafit, ose që të përdoret për qëllime politike partiake.”

7. Në nenin 8, bëhen këto amendamente:

- **Në pikën 3, në fund shtohet fjalia si më poshtë:**

“Deklarata me shkrim e deputetit për konfliktin e interesit rast pas rasti, publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit në internet.”

- **pas pikës 3, shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:**

“3/1. Deputeti nuk ka të drejtë të votojë për një projektligj ose dokument tjetër politik kur ka konflikt interesi dhe as nuk duhet të promovojë projektligje apo interesa për shpërblim/pagesë ose për përfitime direkte/indirekte.”

8. Në nenin 14, pika 5 bashkohet me nenin e ri 14/1

9. Pas nenit 14, shtohet neni 14/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 14/1

Lobimi në Kuvend

1. Deputeti mund të ndihmojë organizata të shoqërisë civile/grupe interesi ose persona, të cilët llojnë për të propozuar nisma ligjvënëse në Kuvend.

2. Deputetit i ndalohet të llojë në këmbim të pagesave, stimujve ose shpërblimeve të tjera.

3. Marrëdhëniet e deputetit me lobistët dhe organizatat e shoqërisë civile/grupeve të interesit duhet të udhëhiqen nga parimet e integritetit dhe transparencës.

4. Transparenca e kontakteve të deputetit me lobistët, organizatat e shoqërisë civile/grupeve të interesit dhe palët e treta zbatohet për të gjitha kontaktet, duke përfshirë kontaktet jashtë mbledhjeve të Kuvendit dhe komisioneve të tij.

5. Deputeti regjistron çdo takim me palët e jashtme, që i shërbejnë atij për të lobuar në një çështje të veçantë, si masë politike ose legjislative.
6. Në Kuvend krijohet Regjistri i lobizmit, grupeve të interesit dhe organizatave të shoqërisë civile që mbajnë marrëdhënie me deputetin dhe komisionet parlamentare, me qëllim pjesmarrjen e publikut në procesin legjislativ. Regjistri administrohet nga shërbimi përgjegjës për deputetët.
7. Regjistri publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit. Ai është i ndarë në bazë të fushave të përgjegjësisë së komisioneve të përhershme parlamentare.
8. Regjistri përditësohet çdo fillim legjislature, bazuar në thirrjen publike të interesit që Kuvendi i drejton organizatave dhe grupeve të interesit që janë të interesuara të bashkëpunojnë me të.

10. Pas nenit 15, shtohet neni 15/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 15/1
Kufizimi i imunitetit

1. Deputeti nuk duhet të përfitojë nga imuniteti i tij për të abuzuar me pushtetin dhe për të shmangur arrestin, heqjen e lirisë në çfarëdo formë, ose ushtrimin e kontrollit personal a të banesës për kryerjen e një krimi të rëndë, përfshirë korrupsionin dhe shpërdorimin e detyrës.
2. Kodi i Sjelljes nuk kufizon të drejtat dhe imunitetin e deputetit, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi dhe Rregullorja e Kuvendit.
3. Procedura për heqjen e imunitetit rregullohet nga legjislacioni në fuqi.

11. Në nenin 16, pika 3, kalon në nenin 8, pika 3

12. Pika 1 e nenit 17, kalon në nenin 3, shkronja “gj” tek ruaja e konfidencialitetit.

13. Pas nenit 17, shtohet neni 17/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 17/1

Kufizim pas përfundimit të mandatit

1. Gjatë ushtrimit të funksionit, deputeti kryen detyrat e tij parlamentare pa u ndikuar nga mundësitë potenciale të karrierës së ardhshme në sektorin privat, ose pa u ndikuar nga ish kolegët.
2. Një vit nga përfundimi i mandatit, deputeti nuk mund të hyjë në marrëdhënie kontraktuale konsultuese ose kontratë pune biznesi ose individuale me Kuvendin.

14. Pas nenit 18, shtohen nenet 19 dhe 19/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 19

Orientimi dhe këshillimi i deputetit

1. Në çdo fillim mandatit të Kuvendit zhvillohen veprimtari orientimi, këshillimi dhe shkëmbimi të përvojave ndërmjet deputetëve të rinj dhe atyre me përvojë të gjatë legjislative si dhe shërbimeve mbështetëse të Kuvendit.

2. Kodi i sjelljes së Deputetit si dhe të gjitha aktet ligjore bazë që kanë lidhje me ushtrimin e funksionit të deputetit u vihen në dispozicion të gjithë deputetëve, grupeve parlamentare dhe partive politike që përfaqësohen në Kuvend.
3. Deputeti mund të konsultohet me një organ të caktuar para se të veprojë për një çështje etike, kur është në dyshim për rrjedhën e veprimit të kryer prej tij, ose që mund të kryejë.

Neni 19/1

Vlerësimi i Kodit

1. Të paktën një herë në vit, Kodi i sjelljes së Deputetit i nënshtrohet vlerësimit për nivelin e zbatueshmërisë së tij.
2. Vlerësimi për zbatimin e Kodit bëhet në një takim konsultativ me organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e interesit që bashkëpunojnë ngushtë me Kuvendin.

15. Neni 20 kalon në kreun VI

Relatore

Vasilika Hysi

